

Përshëndetje Bashkia e Pukës!

Kjo është një kërkesë për informacion.

Në cilësinë e gazetarit dhe nën premisën se informacioni mjedisor është një e drejtë dhe një e mirë publike, lidhur me pyjet e gështenjës, kërkoj si vijon,

Refëruar dëmit që po shkakton, prej disa vitesh, një insekt i dëmshëm ndaj masiveve pyjore të gështenjës, kam nevojë për të dhënat e mëposhtëme,

1. Cilat janë zonat e prekura (fshatrat, pyjet, shtigjet etj) dhe sa hektarë janë prekur në secilën zonë të përshkruar?
2. Ju lutem, sipërfaqen totale për secilën zonë dhe shkallën e prekjës të këtij volumi (Pra, raportin).
3. A keni një raport, apo një dokument që përshkruan këtë historik; nëse po, ju lutem të ma dërgoni.
4. Lidhur me insektin e dëmshëm që ka prekur gështenjën, a keni kryer monitorime vjetore? Nëse po, a mund të më dërgoni rezultatet e monitorimeve?
5. Sa është shumë e përgjithshme e shpenzuar, nga 2018, për rikuperimin e pyjeve të dëmtuara? Ju lutem, të m'i shpërndani sipas zërave dhe sipas viteve në të cilat janë përdorur.
6. Cila janë sipërfaqet e trajtuara (sa hektarë dhe për çfarë trajtimi bëhet fjalë, konkretisht? Pra, fjala është jo vetëm për të luftuar insektin, por edhe shërbime të tjera: pastrim, krasitje, mirëmbajtje fondi pyjor etj.
7. Cilat janë projektet (në bashkëpunim me organizatat apo grupet e mëdha financiare: BB, BE, FAO, Ministria e Bujqësisë etj) që keni zhvilluar për trajtimin e këtij problemi)?
8. A parashikoni fonde nga bashkia për administrimin e pyjeve të gështenjës në pesë vitet e ardhshme? Konkretisht, për cilat zëra?
9. Sa i madh është dëmi ekonomik i shkaktuar nga dëmtimi: në hektarë të prekur; në prodhim; në të ardhura? (Nëse keni ndonjë raport apo ndonjë vlerësim për këtë)?

Faleminderit!

Gjithë të mirat!

Artan Rama

Freelance Journalist&Director

+355 69 20 83 304 (ALB)

artanrama@gmail.com

www.elementipeste.al